

FAKULTETI I EDUKIMIT



PROEJKT I MBËSHTETUR NGA UNICEF KOSOVO
PROGRAM

IMPLEMENTUAR NGA FAKULETI I
EDUKIMIT/UP

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Zhvillimi profesional i vazhdueshëm për edukimin e integruar në fëmijërinë e hershme. Një domosdoshmëri dhe nevojë e edukatoreve në shërbim

Punoi: Salie Gajtani-Osmankaq



Qershor, Prishtinë – Kur Oskar Wilde ka thënë se “Mënyra më e mirë për t’i bërë fëmijët të mirë, është që t’i bëni ata të lumtur”, sigurisht që e ka ditur se të parët janë prindërit dhe mësuesit ato/ata që ndikojnë drejtpërdrejtë në lumturinë e fëmijëve.

Për ta arritur që çdo fëmijë nëpër grupet e tyre të ndjehet mirë dhe e/i lumtur, mbi 280 edukatorë që punojnë nëpër Institucionet Parashkollore (IP), tash e disa javë (ditëve të vikendit) po përcjellin Modulet e trajnimeve për ofrimin e shërbimeve të integruara në fëmijërinë e hershme, të organizuara nga Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës, me mbështetje nga Zyra e UNICEF-it në Kosovë.

Mimoza Morina-Veseli, nga Kopshti “Xixëllonjat” në Prishtinë është vetëm njëra ndër to. Ajo dhe shumë kolege të saj nga anë të ndryshme të vendit, janë kthyer sërish në Fakultet për të qenë pjesë e trajnimeve profesionale që sjellin shkëmbime përvojash dhe metodologji nga praktikatat më të fundit, zbatimi i të cilave bën që fëmijët të ndjehen njësoj, të mësojnë e të zhvillohen përmes lojës dhe mbi të gjitha të jenë të lumtur gjatë qëndrimit në kopsht. Të ulura nëpër karrige, duke punuar në grupe, si dikur gjatë studimeve, ato ndjehen me fat që po u ofrohen këto trajnime.

Mimoza tregon se së fundmi ka ndjekur modulën e tretë me titull “Zhvillimi i vlerave dhe barazia gjinore në fëmijërinë e hershme”. Dy modulet tjera që tashmë i kishte përfunduar ishin “Zhvillimi në fëmijërinë e hershme” dhe “Të nxënit përmes lojës”. Deri në fund të vitit ajo do të jetë pjesë edhe e tri moduleve me tema shumë atraktive për të.

I gjithë programi i trajnimit ka qenë shumë i mirëseardhur për punëtorët e institucioneve parashkollore, thotë ajo, duke shtuar se “në fillim kanë qenë vetëm dy edukatore, por pastaj me kërkesën tonë dhe duke i parë si shumë të dobishme këto trajnime, është përfshirë edhe një pjesë e madhe e stafit”.

Ajo ka theksuar se pavarësisht përgatitjes paraprake dhe përvojës që edukatorët kanë në IP-të, trajnimet janë më se të domosdoshme, sepse sipas saj, gjërat shumë shpejt po ndryshojnë dhe zhvillimi tekniko-teknologjik që po i prek edhe fëmijët, po e bën të veten.

“Pavarësisht përvojave tona, sa të gjata janë ato, ne kemi vërejtur se na duhen ndryshime në punën tonë gjatë përditshmërisë me fëmijët, sidomos në aspektin psikologjik. Shumë herë kemi menduar se ne po veprojmë mirë dhe po i motivojmë fëmijët kur u kemi dhënë shpërblime, por asnjëherë nuk e kemi menduar anën tjetër se me këtë mund të lëndojmë fëmijët e tjerë përdërisa e kemi lavdëruar vetëm një fëmijë”, thotë Morina-Veseli.

E këtë gjë, ajo e kishte kuptuar tek pasi kishte ardhur për të ndjekur trajnimet.

“Këtë metodë e kemi eliminuar tërësisht tani dhe falë trajnimeve kemi gjetur forma dhe metoda se si t’i balancojmë këta shembuj”, shton ajo.

Zejnije Sahiti, është edukatore mbështetëse, e cila punon me fëmijët me nevoja të veçanta në IP “Dardania” në Gjilan. Pas një javë të lodhshme me punë, ajo udhëton nga Gjilani në Prishtinë për t’iu bashkuar trajnimeve që ofron Fakulteti i Edukimit. Ajo thotë se ky është i pesti trajnim që ka ndjekur gjatë vikendeve në këtë institucion. Sipas saj, trajnimet që u ofrohen edukatoreve janë tejet të mirëseardhura, sepse në to po u ofrohen risi stafit të IP-ve.

FAKULTETI I EDUKIMIT



Kjo, sipas saj, është një vlerë e dalë nga trajnimi dhe është vërejtur se ka reflektuar shumë mirë në praktikë.

“Janë një mori vlerash tjera që i kemi mësuar këtu dhe po i praktikojmë në përditshmëri gjatë punës. Edhe pse këto trajnime po bëhen ditëve të vikendit dhe po na humbet pushimi, unë mezi pres të vij e t'i ndjekë ato, sepse janë shumë të dobishme dhe të vlefshme. Jam e pajtimit që, jo vetëm të mos ndërpriten por edhe të zgjerohen (shtohen), sidomos trajnimet me fokus në fëmijët me zhvillim të vonshëm apo aftësi të kufizuaranevoja të veçanta”, ka thënë ajo.

Adelina Pocesta, është një tjetër edukatore që po ndjek këto trajnime. Ajo ka një përvojë të gjatë si edukatore mbështetëse në IP “Ardhmëria 1” në Gjilan. Ajo u është rikthyer bankave dhe mësimeve pas shumë vitesh që kur ka diplomuar, përgjithërisht 15 vite përvojë pune.

Thotë se ndjekja e këtyre trajnimeve e ka rifreskuar dhe ka ringjallur tek ajo nevojën për njohuri të reja. Ajo e konsideron këtë si mundësi për avancim dhe domosdoshmëri për çdo edukatore.

Ajo ka thënë trajnimet e fundit që po ofrohen nga Fakulteti i Edukimit po vijnë nga profesorë që kanë diapazon të gjerë dhe shumë njohuri nga fusha e fëmijërisë së hershme të bartura edhe nga jashtë vendit.

Ajo ka përmendur një diskutim që kanë pasur rreth një rasti të një fëmije me aftësi të kufizuara dhe sfidën që kishte pasur kur prindërit nuk e pranonin se fëmija i tyre kishte aftësi të kufizuara.

“Unë jam e vetëdijshme se nuk isha personi adekuat për të dhënë diagnoza për fëmijët, por unë e kisha obligim ta njoftoja prindin për vështirësitë që i kishte fëmija, i cili nuk zhvillohej krahas fëmijëve të tjerë të grup-moshës, së cilës ai i takon”, ka thënë Pocesta.

“Unë mezi i pres të ndjek këto trajnime dhe njohuritë që i marr këtu menjëherë i vë në zbatim dhe i praktikoj gjatë punës sime”.

Duke përmendur një ndryshim konkret që ajo tashmë ka filluar ta praktikojë gjatë punës, ajo ka thënë se praktikon eliminimin e mundësisë që fëmijët të mashtrohen se prindërit po i lënë vetëm për një kohë të shkurtër në kopsht dhe se ata do të kthehen për t'i marrë shumë shpejt.

“Kemi pasur raste të shpeshta kur prindërit kanë sjell në kopsht fëmijën që kundërshton të ndahet nga ta, duke i thënë se do të vijnë ta marrin në ora 12, ndërsa neve na i mbyllnin njërin sy, duke na bërë me dije se fëmijën nuk do ta marrë para përfundimit të orarit të punës”, ka thënë Sahiti.

Ajo ka shtuar se gjatë trajnimeve e ka kuptuar se kjo është një mënyrë shumë e dëmshme, të cilën e ka eliminuar dhe nuk lejon më që fëmijëve të mos u thuhet e vërteta. Ajo e ka thënë se këtë gjë, pastaj e kanë pranuar edhe prindërit e edhe fëmijët kur u është sqaruar se sjellja e atillë nuk është në dobi as të fëmijës, as të prindit e as të edukatores.



Ajo tutje ka shtuar se *“e kisha shumë të vështirë të komunikoja me atë prind, sepse ai nuk e pranonte. Por, pas trajnimit që kam bërë këtu, unë kam ndërruar qasjen në komunikimin me prindërit, duke marrë njohuri mbi atë se çfarë duhet t'i them prindërve të fëmijës në mënyrë që ata të bindet që fëmijën e vet ta dërgojë për diagnostifikim”,* është shprehur ajo. Sipas saj, pas një periudhe të gjatë kohore të refuzimit të prindit, ajo ka arritur ta bind atë me shumë pak fjalë që ta dërgojë fëmijën e tij në diagnostikim. Ajo vlerëson se trajnimet e këtilla janë të nevojshme dhe nuk duhet të ndërpriten në asnjë mënyrë, sepse kjo po ndikon në avancimin e metodologjisë së punës me fëmijët e moshës së hershme.

